



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr. 923/19 Prot.
Datë: 15.06.2020

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 05. 06. 2020

VENDIM

Nr. 34, datë 05. 06. 2020

PËR PAGESËN E ANËTARËVE TË GRUPEVË TË PUNËS PËR APLIKIM DHE SHKRIM PROJEKTESH

Në mbështetje të nenit 49, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr. 29, datë 10. 09. 2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", shkresës nr. 1467/2 prot, datë 19. 12. 2019 të Rektorit, shkresës nr. 1528/2 prot, datë 18. 11. 2019 të Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë , në mbledhjen e datës 05. 06. 2020 Bordi i Administrimit

VENDOSI

1. Të miratojë pagesën e grupeve të punës për shkrimi projekti sipas shkresës nr. 45/3 prot, datë 24. 01. 2020, shkresën nr. 1467/2 prot, datë 19. 12. 2019, shkresës nr. 1528/2 prot, datë 18. 11. 2019, si dhe sipas shkresës për Buxhetin miratuar me vendimin BA nr. 25, datë 09.04. 2020.
2. Me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare BA do të shqyrtojë kërkesat e tjera për pagesa për shkrim projektsh vetëm pasi të jetë ndjekur procedura e përcaktuar nga ana e Grupit të Punës të ngritur nga Rektorati për këtë qëllim dhe miratuar nga organet/autoritetet drejtuese akademike dhe nga BA. Deri në miratimin e kësaj procedure grupet e punës të shkrimeve të projekteve ose autoritetet drejtuese të vënë në dijeni dhe të bashkëpunojnë me Administratoren dhe Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse për llogaritjen e efekteve financiare të pjesmarrjes në projekte.
3. Në mbështetje të nenit 31 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe Udhëzimit nr. 29, datë 10. 09. 2018, kërkohet të respektohet marrja e një miratimi paraprak nga ana e Bordit të Administrimit në rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit më karakter financiar dhe kur personeli akademik është i përfshirë në veprimtari të pagueshme që nuk janë përfshirë në buxhet.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

5. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Organeve dhe Autoriteteve drejtuese të UV-së, drejtuesve të Njësive Kryesore dhe Bazë, si dhe Drejtorisë së Sigurimit të Cilësisë dhe Projekteve.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr. Ervis Moçka – Kryetar



Anjeza Shiko – Anëtar

Rajmonda Simoimeri – Anëtar

Enrik Mehmeti – Anëtar

Dr. Marinela Muço – Anëtar

Dr. Enida Pulaj – Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj – Anëtar